



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 26/2015

Prishtinë, më 16.7.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Millosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Blerim Grainca dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Sala Berisha–Shala, Fatmir Rexhepi, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Zejnullahu-AMPEK; Kaltrina Ahmeti dhe Tringa Bytyçi- GLPS; Visar Berisha- INDEP; Lejla Selimi dhe Bekim Kodraliu-OSBE; Shqiponjë Osmanaj –RTK; Burim Zariqi- RTV 21; dhe Valmire Hoti- Infodirekt TV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore;

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha së të gjitha komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Raportin me Amendamente të Projektligjit Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore. Komisionet e përhershme i kanë dërguar raportet e tyre dhe nga këto raporte të gjitha komisionet e tjera e kanë përkrahë Projektligjin më amendamente, më përjashtim të Komisionit për Integritet Evropian, i cili ka dhënë vërejtjeje për 3 amendamente, për amendamentin 10, 26 dhe 27. Në amendamentin 10, atë që kemi futur “përveç transmetuesit publik, asnjë ofrues tjetër i shërbimeve mediale nuk mund të jetë operator i multipleksit” këta kanë konsideruar së është përjashtues dhe diskriminues ndaj të tjerëve, gjithashtu kemi reagimin e KPM-së, por edhe të industrisë së mediave. Mustafa tha se meqenëse kemi disa subjekte që kanë pikëpamje të ndryshme dhe kanë dhënë vërejtjeje në këtë amendament, konsideroj se duhet ta heqim ose ta riformulojmë amendamentin 10.

Raif Qela, kryesues i grupit të punës, tha që Amendamenti 10 është qenësor për ta ruajtur të ardhmen e fushës së mediave prej monopolizimit, po them këtë sepse një pronar i fushës së mediave po të jetë edhe ofrues i shërbimeve mediale, ka mundësi që konkurrentët e tij t’i eliminojë, ka mundësi të mos ju ofrojë kushte të barabarta edhe si të tillë eliminohen, prandaj mendoj që ky amendament duhet të qëndrojë patjetër, dhe nuk është vërtetë, siç kanë thënë ata, se nuk përkon me praktikën më të mira evropiane. Qela theksoi së plotë shtete i kanë të ndara saktësisht operatorët e multipleksit prej ofruesve të shërbimeve mediale. Herën e kaluar pa presion më vullnet të lirë, të gjithë u pajtuam që duhet të bëjmë përpjekje që të bëjmë një konkurrencë të barabartë për të gjithë që kjo fushë të zhvillohet normalisht, që të mos ketë diskriminim ndaj askujt dhe favorizim për askënd. Andaj, prandaj heqja e këtij amendamenti do të thotë krijimi i mundësisë për monopol medial. Do të ketë mjaft vend për të gjitha këto programe më këta multipleksë që ofrohen, ndërsa heqja e këtij amendamenti do të thotë çdonjëri cilido qoftë, qoftë edhe BBC-ja, nëse konkurron këtu ka mundësi që t’i bllokojë, nuk është çështje veç të ofruesit e shërbimeve mediale vendore por edhe ndërkombëtare. Nëse ata bëhen zot të fushës së mediave si ta kenë multipleksin në koncesion, ata do ta monopolizojnë tregun, prandaj jam shumë i bindur se kjo mund ta pengojë çështjen e krijimit të monopolit. KPM-ja dhe ARKEP-i nuk kanë ofruar argumente, andaj gjithë kjo fushatë mediale që është ndërtuar dhe ngritur pas amendamenteve tona, përveçse nuk qëndron, është se këto grupe të caktuara të interesit duan t’i krijojnë vetës privilegje. Qela, potencoi së ne nuk duhet të bëmë nën këto presione, pavarësisht së ne jemi sqaruar, në grupin e punës dhe mbledhje të Komisionit. Ai tha, se në debatin kush e ka përcjelle në TV-në me z.Adnan Merovcin, amendamentin e ka interpretuar kështu “se ky amendament në këtë fazë prej transmetimeve analoge në digjitale, nuk jep mundësi askujt prej ofruesve të shërbimeve mediale të jetë edhe operator i multipleksit”. Kjo nuk e përjashton mundësinë që në fazat e mëvonshme ata të kenë mundësi me “beauty contest”. Në fund Qela potencoi se nëse duam që të krijojmë një treg, i cili do të jetë i barabartë për të gjithë, ky amendament është qenësor.

Besim Beqaj tha nëse Komisioni për Integritet Evropian do të vinte më një arsyetim më të fuqishëm se cilat janë nenet që bien ndesh më dispozitat që kanë të bëjnë më fushën për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore, atëherë do të duhej ta ndryshojmë amendamentin, por në bazë të këtyre arsyetimeve që ka dhënë Komisioni për Integritet Evropian, nuk ka argumente bindëse, nuk e kanë cek se me cilën Direktivë kanë ra në kundërshtim amendamentet e Komisionit dhe legjislacioni i BE-së, që nuk njeh praktika të mira

sepse ka rregullim të sistemit kontinental në legjislacion edhe nuk argumente që e përcakton se ka monopol, prandaj ne nuk mund t'a ndryshojmë amendamentin.

Kryetari tha që amendamenti 10 është futur në mbledhje të komisionit edhe nuk ka qenë i propozuar nga grupi i punës, por më vonë kanë ardhur vërejtjet nga industria e mediave dhe se me këtë amendamentet siç është i hartuar kështu, ne po ia pamundësojmë industrisë së mediave hyrjen në konkurrencë të lirë.

Visar Ymeri tha se i gjithë diskutimi në mbledhje të Komisionit ka qenë se si të gjejmë mënyra për parandalimin e monopolit, andaj amendamenti 10 si tillë i dëmton mediat private. Ndërsa, arsyetimi i Komisionit për Integritet Evropian nuk precizon asgjë konkretisht se çka bie ndesh me praktikën më të mirë evropiane. Ai theksoi se ne duhet t'i diskutojmë çështjet në tërësi për të mos krijuar monopol.

Raif Qela në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës, theksoi se grupi i punës për Projektligjin për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore ka punuar gjatë gjithë kohës që ta parandalojë monopolin në këtë fushë shumë të ndjeshme për opinionin publik.

Kryetari, propozoi që të shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i këtij projektligji dhe gjatë mbledhjes së radhës tha se do t'i shqyrtojmë dhe do t'i analizojmë të gjitha praktikën e mundshme që e rregullojnë këtë fushë. Ai theksoi se pas miratimit të këtij Projektligji, do të kërkohej që të kemi cilësinë e produkteve edhe shërbimeve më të mira, krijimin e barazisë dhe konkurrencës së lirë dhe moslejimin e monopolit që t'i mbrojmë interesat e industrisë së mediave.

Pas debatit, Komisioni nxori:

Konkluzion

Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore dhe rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian shtyhet për mbledhjen e radhës.

3. Te ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa